

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përplasje diplomatike Britani-Izrael, Londra vendos sanksione ndaj kolonive në Bregun Perëndimor – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/perplasje-diplomatike-britani-izrael-londra-vendos-sanksione-n-daj-kolonive-ne-bregun-perendimor/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	8 shtator 2026, 22:26:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 20:32:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1bd78bd4c0b4a72e816e2e91ce94adb95f5b9a71bdbb870b1e130e61b0de1fed
TEKSTI	e1717317a934143513680252a0a3857ec732218231d08158e5791576cde8f4bb
PAMJA	2aca2d23b8ee90937d93e96522f8ef799aa20d92822a57f202935a6d78796539

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bc73a97134f443bdd5e3301c31eb5d9716d6ea2880e695e689fa1a7b1e5acf5c
E MËPARSHMJA	188882fa88e5d60c4736e649b25d1c18b3ea7a9ccc386af792a84625fb3e28fe
RRËNJJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bc73a97134f443bdd5e3301c31eb5d9716d6ea2880e695e689fa1a7b1e5acf5c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Madhe dhe Izraelit është shkaktuar nga vendimi i Londrës për të vendosur sanksione ndaj planit për zgjerimin e kolonive izraelite në Bregun Perëndimor të pushtuar.

Qeveria britanike ka shkuar deri aty sa të flasë për “spastrim etnik” ndaj palestinezëve nga kolonë ekstremistë, raporton Independent.

Reagimi i Izraelit ka qenë i menjëhershëm. Tel Avivi është kundërpërgjigjur duke mbyllur misionin diplomatik britanik që merret me çështjet palestineze, duke hapur një tjetër front në marrëdhëniet tashmë të tensionuara mes dy vendeve.

Duke njoftuar sanksionet tregtare, ministri i Jashtëm britanik Ed Miliband deklaroi se qeveria në Londër vlerëson se në disa zona të Bregut Perëndimor po zhvillohet një “spastrim etnik i palestinezëve”, i cili, sipas tij, kryhet nga “kolonë terroristë”.

“Shumë shpesh qeveria izraelite ka bërë një sy qorr dhe, edhe më keq, anëtarë të saj kanë bërë deklarata dhe kanë ndërmarrë veprime që mbështesin zhvendosjen me forcë të palestinezëve”, deklaroi Miliband.

Termet “spastrim etnik” dhe “zhvendosje e detyruar” konsiderohen veçanërisht të rënda në të drejtën ndërkombëtare, pasi lidhen historikisht me krime të kryera ndaj popullsisë.

Vendimi i Britanisë lidhet me kolonitë izraelite në territoret e Bregut Perëndimor të pushtuara nga Izraeli në vitin 1967, të cilat konsiderohen të paligjshme nga një pjesë e madhe e komunitetit ndërkombëtar.

5 **Soreca: Zëri i të rinjve duhet të dëgjohet, janë e ardhmja e Shqipërisë**

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

Përfshirja britanike në historinë moderne të Izraelit dhe palestinezëve nis që në vitin 1917, kur qeveria e Londrës nxori Deklaratën e Balfourit.

Në letrën e ministrit të atëhershëm të Jashtëm, Arthur Balfour, drejtuar lord Rothschild, Britania shprehte mbështetjen për krijimin e një “vatre kombëtare për popullin hebre” në Palestinë, me kushtin që të mos cenoheshin të drejtat e komuniteteve johebreje që jetonin në atë territor.

Për shumë njerëz në botën arabe, Deklarata e Balfourit shënoi fillimin e një padrejtësie historike dhe të një projekti kolonial që çoi në dekada konfliktesh.

Për një pjesë të madhe të diasporës hebraike, nga ana tjetër, ajo përfaqësoi momentin kur një fuqi e madhe njohu të drejtën për krijimin e një shteti hebre.

Megjithëse sanksionet e reja britanike synojnë kolonitë dhe jo Izraelin në tërësi, zbatimi i tyre mund të ketë pasoja më të gjera.

Shumë produkte të prodhuara në kolonitë e Bregut Perëndimor deklarohen me origjinë nga Izraeli, çka e vështirëson dallimin mes produkteve të kolonive dhe atyre të prodhuara brenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht të vendit.

Kjo krijon rrezikun që kompanitë dhe konsumatorët që duan të respektojnë sanksionet të zgjedhin të shmangin në një masë më të gjerë produktet izraelite.

Pikërisht këtë “presion zinxhir” i druhet Izraeli, pasi vlerëson se mund të çojë drejt një fushate ndërkombëtare për izolimin ekonomik të vendit.

Qëndrimi britanik e vendos Londrën në një trajektore përplasjeje si me qeverinë e Benjamin Netanyahu, ashtu edhe me Uashingtonin.

Sipas raportimit, Shtetet e Bashkuara kanë mbajtur tashmë një qëndrim të ashpër ndaj Gjykatës Penale Ndërkombëtare, pas lëshimit të urdhërarresteve ndaj drejtuesve izraelitë nën akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Përplasje lidhet kryesisht me zhvillimet në Gaza pas sulmit të Hamasit më 7 tetor, por edhe me situatën në Bregun Perëndimor, ku organizatat ndërkombëtare denoncojnë rritjen e dhunës nga kolonët ekstremistë.

Pas një informimi mbi situatën në Gaza, Miliband deklaroi se “duhet të veprojme dhe të veprojmë më vendosmërisht”, pak përpara shpalljes së sanksioneve.

Reagimi nga pala izraelite ka qenë i ashpër. Fillimisht, ambasadori amerikan në Izrael, Mike Huckabee, sulmoi përmes rrjeteve sociale qeverinë britanike, duke deklaruar se “britanikët kanë humbur rrugën” dhe duke e akuzuar atë për “urrejtje ndaj hebrenjve”.

Deklarata shkaktoi reagime, pasi vetë ministri i Jashtëm britanik, Ed Miliband, është hebre.

Qeveria britanike argumenton se veprimet e saj janë një përpjekje për të respektuar angazhimin fillestar të Deklaratës së Balfourit, krijimin e një vatre kombëtare për popullin hebre pa cenuar të drejtat e komuniteteve të tjera.

Kritikët e Izraelit argumentojnë se politika e kolonive, konfiskimet e tokave dhe trajtimi i palestinezëve po çojnë drejt një sistemi të pabarazisë së përhershme.

Izraeli i kundërshton akuzat për “apartheid” dhe argumenton se politikat e tij të sigurisë janë përgjigje ndaj kërcënimeve terroriste.

Në çdo rast, sanksionet britanike shënojnë një ndryshim të rëndësishëm të qëndrimit nga ana e një vendi që historikisht ka qenë i lidhur ngushtë me krijimin e shtetit të Izraelit.

Vendimi i Londrës rikthen në qendër të vëmendjes një nga pyetjet më të vështira mbi të ardhmen e konfliktit izraelito-palestinez dhe marrëdhëniet e ndërlikuara të Perëndimit me Izraelin.

#Britani

#Izrael

#VizionPlus



Taulant Halili

Gazetar/je · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



BOTA

Tragjedi! Përmyset anija me pasagjerë,...

Xhuljana
Zhuleku

Dje
23:17



BOTA

Zjarr masiv në Kroaci, evakuohen 230...

Xhuljana
Zhuleku

Dje
19:36



BOTA

Trump: Lufta me Iranin do të...

Xhuljana
Zhuleku

Dje
18:51



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.